



# **RAPORT VJETOR 2024**

[\*\*www.asf.al\*\*](http://www.asf.al)

# PËRMBAJTJA

|                                                   |    |
|---------------------------------------------------|----|
| Mesazhi nga Drejtuesja Ekzekutive.....            | 03 |
| Struktura Drejtuese e Agro & Social Fund .....    | 05 |
| Historiku Institucional .....                     | 09 |
| Rrjeti i degëve.....                              | 10 |
| Misioni & Vlerat Thelbësore .....                 | 11 |
| Sfidat dhe Arritjet 2024.....                     | 13 |
| Qëllime Strategjike për Vitin 2025.....           | 15 |
| Arritjet në kredidhënie.....                      | 17 |
| Menaxhimi i Portofolit në Risk.....               | 21 |
| Menaxhimi i Burimeve Njerëzore.....               | 26 |
| Marketingu 2024.....                              | 28 |
| IT, mbrojtja nga sulmet kibernetike ne fokus..... | 32 |
| Performanca Sociale .....                         | 34 |
| Klientët Tanë .....                               | 37 |
| Raporti i Auditorëve të Pavarur.....              | 38 |
| Bilanci.....                                      | 39 |
| Pasqyra e të ardhurave.....                       | 39 |
| Pasqyra e flukseve të parasë.....                 | 39 |
| Bashkëpunëtorë tanë.....                          | 40 |
| Rrjetet tona Sociale.....                         | 41 |

## Mesazhi nga Drejtuesja Ekzekutive

Të nderuar klientë, partnerë, punonjës dhe bashkëpunorë,  
Kur viti financiar mbyllet dhe të gjithë energjitë nisin e përqëndrohen në marrjen e sfidave për suksesin e radhës, nuk l shmangesh dot nevojës të ndalesh dhe të shohësh rrugëtimin njëvjeçar e mbi të gjitha të analizosh tregues dhe trende, për të identifikuar arritjet dhe më tej dështimet dhe mosrealizimet. Duke qenë falenderues për gjithëkënd që kontribuoi e mundësoi këto arritje, do ndalesha të ndaja disa nga treguesit kryesorë që l dhanë emër të mirë punës e përpjekjeve tona.



Në mbyllje të vitit 2024, llogaritëm që ju kishim shërbyer përgjatë gjithë vitit rreth 2,600 klientëve, nëpërmjet disbursimit të rreth 980 milion lekëve në zhvillimin e bizneseve të tyre. Si rrjedhojë portofoli i kredisë aktive arriti në rreth 1,31 miliard lekë, në funksion të zhvillimit të interesave financiare dhe të biznesit të rreth 3,650 klientëve, duke shënuar një rritje të aktivitetit me rreth 12 % krahasuar me një vit më parë.

Si rrjedhojë e këtij aktiviteti, ne arritëm të ndikojmë pozitivisht në cilësinë e jetës së rreth 6,603 fëmijëve, të 154 klientëve nga grupet e marginalizuara dhe ju besuam gjithashtu ideve të biznesit dhe guximit të shumë të tjerëve të ishin sipërmarrës për herë të parë.

Përtej vështirësive që dallohen në bizneset e zonave rurale dhe aktivitetit të fermerëve në veçanti, ne qëndruam të fokusuar të ruajmë dhe forcojmë partneritetin tonë me ta, dhe siguruam që rreth 53% e totalit të klientëve të jenë më aktivitete që zhvillohen apo kanë lidhje me zonën rurale. Gjithashtu me besimin e palëkundur se gratë kanë një rol qëndror në shoqëri dhe marrin më së shumti vendime të maturuara, vazhduam të mbështesim çdo kërkesë me vëmendjen e duhur, duke siguruar në fundvit që 41 % e numrit të klientëve të kompanisë të jenë gra.

Ky progres është shoqëruar me një zhvillim institucional të matur, që ka synuar të sigurojë rritje të qëndrueshme sa l përket pranisë në territor, duke hapur zyra të reja në zona me potencial siç është

qytetit I Shkodrës, ashtu dhe duke forcuar kapitalin njerëzor duke rritur numrin e rekrutimit të punonjësve të rinj dhe përmirësuar infrastrukturën e punës në zyrat ekzistuese. Për të siguruar paprekshmërinë dhe opertivitetin e sistemeve dhe rrjetit informatik, nga çdo lloj kërcënimi kibernetik, në përputhje me standardet e vendosura nga agjencitë rregullatore, një sërë investimesh janë ndërmarrë dhe do të vijojnë edhe përgjatë vitit 2025.

Për të mundësuar rritjen, siguroam bashkëpunimin dhe partneritetin me kompani ndërkombëtare me të cilat ASF nuk ka patur më parë marrëdhënie dhe u siguroam për vazhdimin e rritjen e bashkëpunimit me kompanitë kombëtare dhe ndërkombëtare me të cilat kemi punuar përgjatë këtyre kohëve. Por mbi të gjitha, jemi përpjekur të motivojmë çdo punonjës dhe bashkëpunor të kësaj kompanie me luajalitetin dhe bashkëpunimin e drejtë e të sinqertë, duke krijuar një sinergji të fortë për të ecur përpara.

Në këtë moment dëshiroj të falenderoj të gjithë ata profesionistë që punojnë në kompaninë që kam nderin dhe kënaqësinë të drejtoj, Bordin përfaqësues për gjithë motivimin e suportin e gjithashtu ato kompani që na mundësojnë të injektojmë fonde për zhvillimin e bizneseve e individëve, të cilët ndërtojnë ëndrrën e tyre dhe rriten me ne, si dhe çdo partneri tjetër që I përgjigjet kërkesës sonë për partneritet. Unë - Ne, besojmë se të mira vijnë vetëm pas punës dhe, në respekt të këtij besimi, Ne ofrojmë vetëm punë.

Na priftë e mbara!



**Rozana OROZI**

Drejtoreshë Ekzekutive



# STRUKTURA DREJTUESE E AGRO & SOCIAL FUND

Agro & Social Fund është e organizuar, si më poshtë:

- Organi më i lartë drejtues është Asambleja Përgjithshme e Ortakut, të cilët kanë zgjedhur një Bord Përfaqësues.
- Në fillim të vitit 2022, me Vendim të Bordit Përfaqësues të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë u krijua Komiteti i Auditit.
- Drejtori Ekzekutiv, zbaton politikat e miratuara nga Ortaku i Vetëm dhe është përgjegjës për drejtimin institucional dhe administrimin e përgjithshëm.
- Mënyra e funksionimit dhe kompetencat që ata kanë janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 të Shoqërive Tregtare si dhe në statutin e Agro & Social Fund.

## ANËTARËT E BORDIT PËRFAQËSUES TË AGRO & SOCIAL FUND



Prof. Asoc. Dr. **BAJRAM MUÇAJ** është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, ka një diplomë pas-universitare në Menaxhim Biznesi dhe “Doktor i Shkencave” me Temë: “Institucionet mikrofinanciare në Shqipëri dhe perspektiva e tyre në lidhje me zhvillimin e politikave”. Ai ka marrë titullin Profesor i Asociuar në korrik të vitit 2011. Ka një përvojë mjaft të gjatë në sektorin e mikrofinancave, që nga maji i vitit 1999 është Drejtori Ekzekutiv i Fondit Besa. Që në vitin 2002 kryen dhe rolin e Profesorit të Jashtëm. Që nga shtatori i vitit 2008 ai mban gjithashtu postin e Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit ABC. Gjatë periudhës shtator 2000-korrik 2005 ka qenë Anëtar Bordi i Komitetit të mbikqyrjes në Bankën e Shqipërisë.




Anëtar Bordi, Prof. Asoc. Dr. **ALTIN MUÇA** është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë në vitin 1992. Deri në vitin 2003 ka punuar si Profesor në Departamentin e Marketingut dhe Turizmit të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2003 ai iu bashkua Fondit Besa në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Marketingut. Ai ka disa kualifikime nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe nga Agjensia e Bashkëpunimit Ndërkombtar Japonez. Ka marrë pjesë në disa seminare me temë “Financimi i Tregtisë Ndërkombëtare dhe Marketingut Ndërkombëtar” për të cilat është certifikuar. Në shtator të vitit 2003 ai mori titullin Doktor i Shkencave dhe në korrik të vitit 2011 mori titullin Profesor i Asociuar.



Anëtar Bordi, Znj. **LUIZA SHEHU** me një eksperiencë të gjatë në sektorin Ligjor, është diplomuar në Fakultetin Juridik në vitin 1995. Ka mbajtur pozicionin e Drejtorit në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Në vitin 2004 mori një diplomë masteri për Administrim Publik në Universitetin e Nebraskës. Ajo iu bashkua sektorit të mikrofinancës në vitin 2007, në pozicionin e Drejtorit Ligjor, Burimet Njerëzore & Departamentit të Administrimit të Brendshëm në FAF. JSC (ish MAFF). Që në vitin 2016 mban postin e Drejtorit të Departamentit Ligjor të Fondit Besa. Disa përvoja të tjera pune përfshijnë: Pedagoge e Ligjit Bankar dhe Sigurimeve, Eksperte legale e GTZ, Avokate e licensuar që në vitin 2013.


## *Agro & Social Fund është i organizuar në 5 departamente:*



Të gjithë drejtuesit e Departamenteve varen nga Drejtori Ekzekutiv dhe secili prej tyre ka staf nën varësi që ndihmojnë në mirëadministrimin e proceseve të punës.

Agro & Social Fund operon në 7 Degë Rajonale (Tiranë, Durrës, Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Korçë, Fier ) dhe 6 Nëndegë (Tiranë, Laç, Bilisht, Pogradec, Librazhd, Shkodër).

Në nivel menaxhimi në degë, struktura është: Drejtor Dege, Përgjegjës Dege (sipas vlerësimit), Asistente Dege, Oficerë Kredie dhe Staf Ndihmës.



# HISTORIKU INSTITUCIONAL

**NËNTOR  
2016**

VisionFund International vendos tërheqjen e përfaqësisë së tyre nga Shqipëria, kështu që në muajin Dhjetor 2016, u arrit marrëveshja e shitjes së Institucionit tek Fondi Besa sh.a, institucioni financiar jobankar më i madh në Shqipëri.

**NGA  
DHJETOR  
2016**

Fondi Besa është pronari dhe Ortaku i Vetëm i këtij institucioni me zotërimin e 100% të aksioneve.

**DHJETOR  
2009**

Agro & Social Fund mori liçencën nga Banka e Shqipërisë Nr. 17, si Institucion Financiar i Mikrokredisë.

**2009**

Kalon Institucion Mikrofinanciar me status ligjor “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” - Vision Fund Albania. Në pronësi dhe kontroll 100% të VisionFund International degë e orld Vision International.

**2001**

Krijohet “Building Future” si program mikrofinanciar i orld Vision Albania, fillimisht me hapjen e zyrës së parë në rajonin e Lezhës.

# RRJETI I DEGËVE TË AGRO & SOCIAL FUND



**Dega Rajonale Lezhë** – 2001

**Dega Rajonale Korçë** – 2003

**Nën Dega Laç** – 2007

**Nën Dega Librazhd** – 2008

**Dega Rajonale Elbasan** – 2011

**Dega Rajonale Tiranë** – 2018

**Nën Dega Tiranë** – 2020

**Nën Dega Pogradec** – 2018

**Nën Dega Bilisht**

**Nën Dega Shkodër** – 2024

**Dega Rajonale Lushnje** – 2020

**Dega Rajonale Durrës** – 2021

**Dega Rajonale Fier** – 2023



# MISIONI & VLERAT THELBËSORE

## *Misioni i Agro & Social Fund*

“Agro & Social Fund” shpk mbështet zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen financiare dhe kohezionin social, nëpërmjet asistencës së përgjegjshme financiare, kryesisht të ndërmarrjeve mikro e të vogla dhe individëve, me qëllim lehtësimin e përmirësimit të jetesës, zgjerimin e oportuniteteve për sipërmarrje e punësim në komunitete si gra, të rinj, apo grupe të ndryshme vulnerabël, me fokus zonat rurale e semi-urbane.

## *Vlerat e Agro & Social Fund*

“Agro & Social Fund” shpk është i fokusuar në përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve që i ofrohen klientelës së synuar, kryesisht nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të kërkesave të tyre, krijimit të mundësive për klientët, familjet dhe komunitetet në rritjen e mirqënies, uljen e varfërisë apo vulnerabilitetit, rritjes së aksesit në financë, krijimit të vendeve të reja të punës apo dhe shtimit të vlerës së atyre ekzistuese. Në rrugëtimin tonë të udhëhequr nga misioni, ne ruajmë e pasurojmë vlerat tona.

Ne përpiqemi t'i shfrytëzojmë këto vlera me qëllimin që të sigurojmë punonjës të motivuar dhe të orientuar drejt rritjes së rezultateve dhe mbrojtjen nga devijimi i misionit, punonjës që do arrijnë të zhvillohen e veprojnë në sintoni të plotë me linjën për rritjen e objektivave të institucionit.

**V**

Ne jemi të përkushtuar për të punuar pranë njerëzve, me qëllim nxitjen e përmirësimit të jetës së tyre.

**L**

Ne jemi besnikë ndaj qëllimit dhe të përgjegjshëm për burimet që na janë besuar, duke i menaxhuar ato në mënyrë të tillë që të sjellin kthimin maksimal për kompaninë dhe klientët tanë.

**E**

Ne vlerësojmë njerëzit, i konsiderojme të barabartë dhe u japim atyre përparësi atyre përkundrejt fitimit e qëllimve tradicionale të biznesit, strukturave e sistemeve.

**R**

Ne jemi punonjës dhe një kompani e besuar në treg – ajo e cila qëndron për integritetin dhe vendos një standard për të, duke frymëzuar të tjerët të jenë gjithmonë të besueshëm dhe të ndershëm.

**A**

Ne vlerësojmë e promovojmë transparencën dhe sjelljen etike.

## SFIDAT & ARRITJET 2024

Edhe pse viti 2024 ishte një vit i vështirë, me paqëndrueshmëri ekonomike ku efektet e rritjes së çmimeve nga njëra anë, apo rritjes së konkurrencës nga ana tjetër ishin të dukshme, rezultatet e Agro & Social Fund treguan se angazhimi i të gjithë hallkave të institucionit dha rezultat pozitiv mbështetur në strategjinë afatgjatë të institucionit. Rezultati financiar ishte i kënaqshëm, arritëm të firmosim bashkëpunime me partnerë të rinj kombëtar e ndërkombëtar, zgjeruam bashkëpunimin me partnerë aktualë. Në mënyrë të përmbledhur:



Administruam një portofol prej rreth 1.310 miliardë lekë. Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve ju është shërbyer rreth 38,099 klientëve, duke disbursuar rreth 8.9 mld Lekë.



Në mbyllje të vitit 2024, 53% e klientëve i përkisnin zonave rurale dhe 41% kliente femra.



Një staf prej 94 punonjësish ishte në shërbim të 3,636 klientësh.



Retention RATE (Raporti i Ruajtjes së Klienteles) 56.5%



Nga të dhënat e mbledhura rezulton që me financimet tona, kemi ndikuar jetën e rreth 6,603 fëmijëve, në mënyrë direkte apo indirekte



Gjatë vitit 2024, Agro & Social Fund në përmbajtje të planit të zgjerimit, hapi Nën-Degën e Shkodrës, duke shtrirë kështu shërbimet dhe aktivitetin tonë edhe në këtë qytet.



Ka vijuar ngritja e fondeve me partnerin KIVA, vlerësuar për shkak të fee-ve të ulta të fondeve sipas kategorive dhe gjatë vitit 2024 u disbursuan nëpërmjet këtyre fondeve rreth 813,465.00 \$.

## ***“Member Engagement Award” për Borrow Wisely***

Edhe gjatë vitit 2024 #Borrow Wisely, vazhdoi traditën e realizimit të fushatës së sensibilizimit për një huamarrje të zgjuar. Përgjatë kësaj fushate, “Agro & Social Fund” ndoqi të njëtin format të edukimit dhe ndërgjegjësimit të stafit, klientëve dhe publikut të gjerë, formën online takimet e kontaktet e drejpërdrejta në aktivitete të ndryshme. Si rrjedhojë e bashkëpunimit afatgjatë dhe të sukseshëm, Institucionit “Agro & Social Fund, në Konferencën Vjetore të MFC, të zhvilluar në Krakovë, Poloni, iu akordua çmimi “Microfinance for Female Entrepreneurship”.



# QËLLIME STRATEGJIKE PËR VITIN 2025



ASF deri në fund të vitit 2025 synon të ketë arritur në një portofol kredie me vlerë absolute prej 1.53 mld lekë dhe një klientelë aktive rreth 4190 klientë;



ASF deri në fund të vitit 2025 synon të ketë disbursuar kredi për rreth 3,400 klientë, me një shumë të disbursuar prej 1.1 mld lekë (rreth 11.1 mln Euro);



ASF do të përdorë të gjithë burimet e veta, në formën më të mirë, për të mbajtur NPL-të në nivelin e parashikuar jo më shumë 5 % si dhe do synojë shtimin apo përmirësimin e instrumenteve për kontrollin e risqeve kyçe që kërcënojnë organizatën;



ASF do synojë në vazhdimësi përmirësimin e instrumenteve për dedektimin dhe kontrollin e risqeve kyçe që kërcënojnë organizatën, duke përmirësuar cilësinë e dokumenteve të reja të implementuara brenda 2024-ës;



ASF deri në fund të vitit 2024 synon të forcojë shtrirjen dhe mbulimin me shërbime:

- financiare në zona të synuara rurale e gjysmë urbane, nëpërmjet konsolidimit të
- degëve/zyrave ekzistuese, duke shndërruar zyrën e Shkodrës në degë rajonale;



ASF synon të përmirësojë ofertën e produkteve të saj nëpërmjet përmirësimit të produkteve, në koherencë me zhvillimet, duke projektuar oferta të përkohshme asociuar me sezone specifike dhe duke ju përshtatur nevojave të klientelës.



ASF në kuadër të nismës për të kontribuar në edukimin financiar do të ndërmarrë nisma për të kombinuar më mire financimin me këshillimin, me qëllim përcjelljen e njohurive të nevojshme për kategori të caktuara kryesisht të biznesit, të vetëpunësuarve dhe të rinjve (një dimension I ri i dedikuar i elaboruar në fushatën e fundit 2024). Kjo do të jetësohet duke ndërtuar fushata të ngjashme me Borrow Wisely me qëllim disiminimin dhe zgjerimin e njohurive në këtë drejtim për grupe të caktuara klientele; Sa më lart, do të synohen të realizohen nëpërmjet fondeve të veta apo mbështetjes së fituar me asistencë teknike apo projekte të mbështetura nga EU, MFC, ADGF, apo bashkëpunimit mbi start up-et të Frankfurt School of Finance & Management (FS) me German Development Bank (Kf) etj;



ASF do të synojë rritjen e kapaciteteve të stafit nëpërmjet trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencave si brenda institucionit, ashtu edhe në institucione analoge; lokale apo ndërkombëtare.

# ARRITJET NË KREDIDHËNIE

“Agro & Social Fund” përcakton në mënyrë të qartë strategjitë dhe objektivat për t’iu dhënë prioritet elementëve të rëndësishëm të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen dhe konsolidimin e institucionit. Rritja e kreditimit si një ndër faktorët më të rëndësishëm është lokomotiva që udhëhëq ambicien tonë strategjike për të rritur numrin e klientëve dhe për të mbështetur biznesin e vogël dhe të mesëm në investime dhe zhvillime të tyre me qëllim rritjen e të ardhurave dhe zgjerimin e aktivitetit. Kjo kategori klientele duke qenë motori i ekonomisë së vendit dhe patjetër objketivi jonë për të qëndruar në nivele mikro edhe puna jonë ka konsistuar në diversifikimin e portofolit të kredisë, çka çon në diversifikimin e riskut dhe në sigurimin e një aktiviteti më të qëndrueshem në vazhdimësi.

Duke qëndruar në të njëjtën linjë, por tashmë me shifrat e mbylljes së vitit rezultuan sa më poshtë:



Rritja e numrit të kredive aktive rezulton me 3636 kredi, me një rritje prej 3.56% për vitin 2024.



Rritja e portofolit bruto të kredive aktive rezulton në vlerën 1.310 mld lekë me një rritje prej 11.6% ose 136.5 mln lekë për vitin 2024.



Rritja e numrit të kredive të disbursuara ka qenë 2,613 kredi ose 2.43% më shumë se në vitin e kaluar.



Rritja e volumit të disbursuar ka qenë 971,723,000 lekë ose 6.82% krahasuar me vitin e kaluar.



Nr. Kredi të  
Disbursuara

**2,613**



Volumi Kredi  
të Disbursuara

**979 mln lekë**



Portofol Aktiv

**1.310 mld lekë**



Kredi Rurale

**1,388**



Kliente Femra


**41%**




Klientë të rinj

**46%**

| 2024                 | Nr.   | Vlerë            |      | Kredi të Disbursuara në nr. | Kredi të Disbursuara në vlerë (mln lekë) | Kredi aktive në nr. | Portofol Outstanding (mln lekë) |
|----------------------|-------|------------------|------|-----------------------------|------------------------------------------|---------------------|---------------------------------|
| Kredi të Disbursuara | 2,613 | 971,723,000      | 2020 | 1,813                       | 564                                      | 2,788               | 768                             |
| Portofol Aktiv       | 3,636 | 1,310,736,499.37 | 2021 | 2,133                       | 695                                      | 3,128               | 877                             |
| Kredi Rurale         | 1388  | 546,307,000      | 2022 | 2,256                       | 805                                      | 3,305               | 1,037                           |
| Klientë Vulnerabël   | 153   | 53,190,000       | 2023 | 2,551                       | 917                                      | 3,511               | 1,174                           |
| Klientë të Rinj      | 46%   | 41%              | 2024 | 2,613                       | 979                                      | 3,636               | 1,310                           |
| Kliente femra        | 41%   | 41%              |      |                             |                                          |                     |                                 |



Rritja e portofolit aktiv për periudhën 5 vjeçare rezulton me 30.4% rritje në numër dhe 70.7% në vlerë.





## Produktet tona të Kredisë

### START-UP

Shuma deri në 400,000 lekë  
Afati deri në 36 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### TË RINJTË SIPËRMARRËS

Shuma deri në 500,000 lekë  
Afati deri në 36 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### KREDIA JESHILE

Shuma deri në 1,000,000 lekë  
Afati deri në 48 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### KREDI BIZNESI

Shuma deri në 2,000,000 lekë  
Afati deri në 72 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### KREDIA KONSUMATORE

Shuma deri në 600,000 lekë  
Afati deri në 48 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### KREDI AGRO

Shuma deri në 2,000,000 lekë  
Afati deri në 84 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### KREDIA SOCIALE

Shuma deri në 600,000 lekë  
Afati deri në 36 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### PRODUKTI FAST

Shuma deri në 200,000 lekë  
Afati deri në 18 muaj  
Lëvrim brenda 3 orëve, pa garnator

### GRUAJA RURALE

Shuma deri në 600,000 lekë  
Afati deri në 48 muaj  
Interesi përcaktohet nga shuma  
e kredisë

### PRODUKTI EIF

Shuma deri në 2,500,000 lekë  
Afati deri në 84 muaj  
Interesi 19,5%

# SEKTORËT E INDUSTRIË

## Shpërndarja e portofolit sipas produkteve

- Bisnes

■ Agro

■ Projektet

■ EIF

■ Konsumatore


■ Kredi Jeshile

■ Sociale


■ Start-up

■ Gruaja Rurale

■ Të rinjtë sipërmarrës



## Portofoli sipas Sektorëve



- Tregti

■ Shërbime

■ Bujqësi/Blegtori

■ Individ

■ Prodhim

# MENAXHIMI I PORTOFOLIT NË RISK

Gërshetimi i vlerave, qëndrimeve, kompetencave dhe sjelljeve të përbashkëta organizative, formësojnë kulturën e riskut mbi të cilën mbështetet filozofia dhe qasja e ASF-se ndaj riskut, si edhe varen praktikave të menaxhimit dhe vendimet e bazuara mbi risqet. Kjo qasje ka lejuar zhvillimin e portofolit tonë të kredisë, gjithnjë duke mbajtur në pararojë transparencën ndaj klientit, por edhe monitorimin e të gjitha procedurave, edhe pas kredidhënies.

Per t'u siguruar që janë ravijëzuar përcaktimet e duhura, siç janë: matja e riskut, kufijtë, rregullat, udhëzimet, vendimmarrja e pavarur, kontrollet, monitorimi, testimi dhe raportimi, është krijuar dhe mirëmbajtur nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut një infrastrukturë e përshtatshme e dedikuar, e cila bën të mundur:



Ndërtimin, ruajtjen dhe forcimin e kulturës së riskut;



Ndërtimin dhe monitorimin e riskut, në formën më të mirë;



Ngritjen e një strukture menaxhimi me qëllim “sistemimin” e gjithë zinxhirit funksional që përfshin: identifikim, matje, monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm të riskut

Këto parametra orientojnë si planifikimin strategjik, ashtu edhe vendimmarrjen e përditshme, duke shmangur kështu marrjen e riskut të tepërt dhe duke inkurajuar zhvillimin e kontrolleve të forta, për të mbrojtur burimet kryesore të institucionit.

Departamentit i Menaxhimit te Riskut është pjesë e:



Komitetit të Kredive me Probleme & Provigjionimit



Komitetit të Kredive mbi 1 mln

Si pjesë të aktivitetit normal të biznesit, Departamenti i Menaxhimit të Riskut ka patur nën ndjekje gjatë vitit 2024 llojet e risqeve, të ndara sipas kategorive/nënkategorive të mëposhtme:

| KATEGORIA    | NËN-KATEGORIA                                 |
|--------------|-----------------------------------------------|
| Strategjik   | Risku i Qeverisjes                            |
|              | Risku Reputacional                            |
|              | Risku Ligjor dhe i Përputhshmërisë (Ligjore)  |
| Financiare   | Risku i Kredisë                               |
|              | Risku i Dimensionit Social të Misionit        |
|              | Risku i Tregut                                |
|              | Risku i Likuiditetit                          |
|              | Risku i Normës së Interesit                   |
| Operacionale | Risku i Kursit të Këmbimit                    |
|              | Risku i Kapitalit Njerëzor                    |
|              | Risku i Integritetit të Sistemit/Teknologjisë |

Në vitin 2024, ekonomia shqiptare ka shfaqur rritje pozitive, me një rritje të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe stabilizim të inflacionit. Indeksi i çmimeve të konsumit ka pasur një rritje vjetore prej 2.1%, më e ulët se vitin e kaluar. Grupet që kanë kontribuar në inflacion përfshijnë ushqimet dhe mobiljet, ndërsa çmimet e energjisë kanë pësuar rritje të moderuar. Rritja ekonomike ka qenë e ndikuar pozitivisht nga sektorët si tregtia, ndërtimi dhe aktivitetet e pasurive të paluajtshme. Megjithatë, shkalla e papunësisë ka shënuar një rritje të vogël, ndonëse mbetet më e ulët se një vit më parë. Punësimi ka rënë në sektorët e shërbimeve dhe bujqësisë, ndërsa industria ka shënuar rritje.

Ekonomia shqiptare ka vazhduar të zhvillohet në mënyrë pozitive, duke treguar ritme të qëndrueshme rritjeje, të mbështetura nga performanca e mirë e sektorëve kryesorë dhe stabiliteti i treguesve makro-ekonomikë, që sugjerojnë një perspektivë optimiste për të ardhmen e afërt.

Për një institucion mikrokredie, siç është ASF-ja, të operuarit në një mjedis konkurrues, si ky i ditëve të sotme, e klasifikon mbajtjen nën kontroll të riskut, si një nga shqetësimet kryesore. Sigurimi i portofolit cilësor të kredive, mbajtja e balancave të nevojshme të likuiditetit, ruajtja permanente e disa raporteve përkundrejt kapitalit, ndryshimeve të normave apo mirëpërdorimit të monedhave të përdorura, etj., janë kushte thelbësore, që imponojnë dispozita të ndryshme për menaxhimin e riskut, në funksion të kornizave rregullatore

Menaxhimi i përgjegjshëm i rreziqeve nëpërmjet një qasjeje sistematike dhe të përhershme mbetet një ndër prioritetet e punës sonë. Me anë të mjeteve dhe raporteve të ndryshme analitike, stafi menaxhues identifikon dhe përcakton me kujdes rreziqet potenciale që mund të ndikojnë në njësinë tonë ekonomike duke përfshirë rrezikun e çmimit, rrezikun e kreditit, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e flukseve monetare. Përdorimi i kontratave afatshkurtra, diversifikimi i portofolit dhe monitorimi i vazhdueshëm janë pjesë integrale e strategjive tona për menaxhimin e rreziqeve.


Cilësia e portofolit të kredisë




Rritja e portofolit të kredisë ishte në nivele të kënaqshme gjatë vitit 2024, ndërkohë që niveli i PAR-it mbi 30 ditë, u mbyll me 6.68%.

Provigjionimi, duke patur ndikim kyç në rezultatin financiar të ASF-së, është nën përgjegjësinë e Departamentit të Menaxhimit të Riskut, duke ndjekur rigorozisht rregullat e Bankës së Shqipërisë dhe të standarteve IFRS9, nëpërmjet materializimit me procedura dhe politika rregullatore.

Klasifikimi i portofolit të kredisë - Dhjetor 2024



Lidhur me përbërjen e portofolit të kredive aktive, 93.32 % klasifikohen si “Kredi Standarte”, ç’ka dëshmon një cilësi stabël të portofolit. Fokus i vijim, do të jetë përmirësimi në peshë i klasave mbi 30 ditë.




Në fokus të Departamentit të Menaxhimit të Riskut, edhe për këtë vit ushtrimor, ka qenë shtimi i vigjilencës ndaj parandalimit të mashtrimit, krimit financiar dhe financimit të terrorizmit. Janë ndjekur workshop-et e nevojshme nga entitetet relevante të fushës dhe trajnimet periodike të stafit tonë, për të qenë konform kërkesave rregullatore në fuqi.

## MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

ASF i kushton një vëmendje të veçantë menaxhimit të kapitalit njerëzor, duke rekrutuar, menaxhuar, zhvilluar dhe optimizuar punonjësit për të rritur vlerën e tyre për kompaninë, si dhe duke i konsideruar si një komponent kyç në arritjen e qëllimeve të saj strategjike. Për ne, është e rëndësishme të krijojmë një ambient pune të përshtatshëm dhe dashamirës, ku secili punonjës të ndihet pjesë e ASF. Ky angazhim nuk është vetëm për të siguruar një atmosferë pozitive, por edhe për të mbështetur zhvillimin profesional dhe personal të çdo individi brenda kompanisë. Krijimi i një fryme bashkëpunuese dhe të angazhuar është thelbësore për të arritur objektivat e përbashkëta të biznesit. Kjo qasje ka sjellë një atmosferë pozitive dhe produktive, e cila mbështet rritjen dhe zhvillimin e ASF-së.

### *Numri i punonjësve në mbyllje të vitit 2024*



Agro & Social Fund shpk. ndër vite e kanë shoqëruar ndryshime dinamike, përmirësime të proceseve dhe proceduarave që shoqërojnë kreditimin. Gjatë vitit 2024 ASF punoi për të cuar përpara të gjitha prespektivat e rritjes së saj të nisura dhe më parë, për t'u rritur e për të arritur sukseset e radhës. 6 Qershor 2024 ASF zgjeron aktivitetin e saj duke hapur Zyrën e Re në qytetin e Shkodrës.

Një nga aspektet kyçe të menaxhimit të burimeve njerëzore ka qenë sigurimi i një strukture vlerësimi të drejtë dhe promovuese për stafin, me qëllim për të ndërtuar arritjet e stafit dhe për të rritur motivimin në vazhdimësi për arritje të rezultateve sa më të larta në performancë. Në ASF, vlerësojmë përditë punën e secilit, si dhe shpërblejmë e shprehim mirënjohjen në veçanti për arritjet, për punonjësit, të cilët vendosin pa kursim përpjekjen dhe dedikimin për rritjen e ASF-së. Për punonjësit me performancën më të mirë për vitin e lënë pas (2023), ASF i ofroi në muajin Mars 2024 disa ditë pushimi mes bukurive të qytetit antik të Romës.





Në datën 07 Shkurt 2025, ASF organizoi Analizën Vjetore për vitin 2024! Analiza Vjetore, konsiderohet si një tryezë pune ku strukturat dhe nivelet e menaxhimit paraqesin arritjet, projektet dhe sfidat, nevojat dhe objektivat për të ardhmen nëpërmjet një procesi pjesëmarrjeje dhe nëpërmjet një debati profesional për rritjen e performancës së punës në vazhdim. Gjatë kësaj analize, për të vlerësuar kontributin e dhënë përgjatë vitit 2024, u shpërndanë disa çmime për Oficerët e Kredisë më të mirë të vitit të mirë vjetore, si dhe Dega me performancën më të mirë 2024 u shpall Dega Rajonale Korçë. Si një traditë tanimë e ASF-së, stafi i promovuar me çmime në analizën e zhvilluar përfitoi një udhëtim turistik.

Investimi në zhvillimin e vazhdueshëm të stafit ka qenë një prioritet gjatë vitit 2024. Programet e trajnimit janë zhvilluar për të rritur aftësitë teknike, menaxheriale dhe ndërpersonale të punonjësve, duke mbështetur rritjen e efikasitetit në punë. Trajnime të stafit startojnë që nga trajnimi i orientimit për stafin që i bashkohet për herë të parë ASF-së, deri tek webinarë, workshop-e, trajnime të ofruara si nga institucionet me të cilët kemi partneritet, ashtu dhe nga institucione shtetërore apo grupe interesi në industrinë e mikrofinancës. Edhe gjatë vitit 2024, ASF vazhdoi bashkëpunimin me Swisscontact dhe Partners Albania, trajnime që kanë në fokus teknikat e shitjes dhe sjelljen përkundrejt klientit, ku pjesëmarrës kanë qenë staf nga dega dhe Zyra Qendrore.

Shumatorja e të gjithë trajnimeve të ofruara gjatë viti 2024 për stafin ASF, si nga menaxhmenti ashtu dhe nga partnerët, arrin numrin prej 37 trajnimesh të ofruara për stafin.

# MARKETINGU 2024

ASF gjatë 2024-ës ka qënë e fokusur në për të zhvilluar një marketing sa më gjithëpërfshirës duke mos humbur fokusin si në marketingun tradicional, ajo që zhvillohet drejtëprdrejtrë nga stafi në terren, ashtu edhe në marketingun online. Përgjatë vitit 2024, institucioni ngriti një marrëdhënie me një kompani të jashtme, e cila ka dhe ofron një ekspertizë të specializuar mbi mënyrën sesi të jemi më vizibël në marketimin online, gjë e cila u përkthye në më shumë vizibilitet dhe ndjekës në rrjete sociale të ASF-së. Rrjetet sociale Facebook, Instagram, LinkedIn, kanë synuar një rritje të ekspozimit nëpërmjet rritjes së publikimit të lajmeve, aktiviteteve, njoftimeve, informacioneve, por edhe një rritje të segmenteve të audiencës së synuar.

Duke qëndruar të fokusur në përmbushje të misionit, ASF me rastin e festës së mësuesit dhe gruas, në datat 7 dhe 8 Marsit lançoi një produkt kredie promocional të dedikuar vetëm për individët e stafit pedagogjik, si dhe për çdo grua të interesuar për financim, të cilët nëse aplikonin për kredi vetëm në data 7 dhe 8 Mars përfitonin 0% komision disbursimi dhe me shumë financimi deri në 600,000 lekë.



Gjatë muajit Tetor 2024, ASF zhvilloi fushatën sensibilizuese për një huamarrje të zgjuar #Borrow Wisely. Kjo fushatë nisi paraprakisht me trajnimin e stafit të degëve, për të mundësuar aftësimin e tyre për shpërndarjen e mesazheve, koncepteve dhe detajeve shpjeguese. Në të njëjtën kohë në rrjetet sociale të ASF-së u publikuan me postime të njëpasnjëshme të gjitha elementet e një huamarrje të zgjuar, të cilat i ndihmojnë individët të kuptojnë hap pas hapi se çfarë të kërkojnë në mënyrë që të jenë të mirëinformuar para se të marrin një kredi.

Në muajin Nëntor 2024, Agro & Social Fund iu bashkua fushatës “Mikrofinanca për Sipërmarrësit e Rinj 2024”, e cila u organizua nga Microfinance Centre (MFC) dhe partnerët e saj, e cila ka për qëllim të theksojë rolin e rëndësishëm të sektorit në fuqizimin e sipërmarrësve të rinj.

Sipas raportit Missing Entrepreneurs 2023, rreth 40% e të rinjve në BE, të moshës 15 deri në 30 vjeç, aspirojnë të jenë të vetëpunësuar. Megjithatë, pengesa si mundësitë e kufizuara për sipërmarrje, për krijimin e rrjeteve dhe qasja e kufizuar në financa vazhdojnë të pengojnë të rinjtë që të nisin biznese ose vetëpunësim.

Agro & Social Fund, prej kohësh vijon përpjekjet për mbështetjen e këtij target grupi, duke ofruar një produkt të dedikuar për sipërmarrësit e rinj dhe gjithashtu synon që ky kontribut të konsolidohet më tej në vijim, me qëllim fuqizimin e sipërmarrësve të rinj.



## Aktivitete

Pjesëmarrja në aktivitetet të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit kanë qenë një tjetër fokus institucional, si një mënyrë efektive për të rritur vizibilitetin, për të shkëmbyer njohuri dhe për të ndërtuar lidhe dhe partnership-e që mund të ndikojnë në zhvillimin e institucionit.

Në muajin Maj, ASF mirëpriti në një vizitë pune përfaqësuesit e KIVA-s, Znj.Kendra Thorogood dhe Z.Mircea Onita. Gjatë takimeve të realizuara me ekipin menaxhues u diskutua për ecurinë në tërësi të ASF-së si dhe në veçanti të bashkëpunimit me KIVA-n, si dhe për strategjitë dhe objektivat e së ardhmes; perspektivën e marrëdhënies midis dy institucioneve, duke e konisderuar KIVA-n si një ndër partnerët afatgjatë, në përputhje të misionit social, objektiv i dyanshëm i partneritetit.



Në datat 14-15 Maj 2024, ASF mori pjesë në edicionin e 26-të Konferencës Vjetore të MFC! Drejtori Ekzekutiv dhe Koordinatorja e Projekteve të ASF ishin pjesë e këtij eventi të rëndësishëm, i cili kishtë pjesë të këtij edicioni nën temën "Embracing the diversity for inclusive finance".

Gjatë ditëve në këtë Konference me 400 pjesëmarrës nga 35 vende të botës, përfaqësuesit e ASF-së zhvilluan takime në mbeshtetje apo zgjerim të network-ut të partnerëve me Symbiotics, Inpulse, Frankfurt School- Financial



Services, BIB Fair Banking dhe MCE Social Capital, Grameen Credit Agricole, Blue Orchard, Triodos, etj, si dhe u ndoqën takime në të cilat u diskutuan tema me rëndësi strategjike për sektorin.






Gjithashtu, në këtë konferencë, për të dytin vit rradhazi, ASF-së ju akordua cmimi për kontributin në fushatën Borrow Wisely 2023 -"Microfinance for Female Entrepreneurship".

Në datat 31 Tetor – 1 Nentor 2024, për dy ditë rradhazi përfaqësues të ASF morën pjesë në Konferencën #microbalkans2024 të zhvilluar në qytetin e Sarajevës. Një ngjarje e rëndësishme për zhvillimin e sektorit të mikrofinancës në rajon dhe më gjerë. Konferenca u fokusua në tema të rëndësishme si digjitalizimi, iniciativat ESG me fokus në tranzicionin energjetik dhe rolin e grave në mikrokredi, si dhe diskutime në lidhje me kuadrin rregullator.

Ky event bashkoi ekspertë dhe përfaqësues nga Ballkani Perëndimor dhe jashtë tij, duke krijuar një mundësi për shkëmbim njohurish, rrjetëzim dhe partneritete të reja që do të ndihmojnë në përmirësimin e sektorit.



# IT, MBROJTJA NGA SULMET KIBERNETIKE NE FOKUS

DTI ideoi e vuri në zbatim përgjatë 2024 projekte të rëndësishme lidhur me sigurinë. ASF projektoi, testoi dhe vuri në shfrytëzim 2 sisteme shumë të rëndësishme të cilat janë lider në fushat përkatëse: Sistemet e menaxhimit të pajisjeve fundore e ato të rrjetit janë sisteme të cilat ofrojnë një gamë të gjerë suporti lidhur me sigurinë dhe sulmet kibernetike.




> **Unified Endpoint Management & Security** - një mjet që shërben të menaxhojë, auditojë, monitorojë dhe sigurojë pikat/pajisjet tona fundore . UEMS ka të integruar administrimin e pajisjeve që janë të lëvizshme si dhe ato që ndodhen në vende të palëvizshme, përveç veçorive të integruara të sigurisë. Me fokus kryesor në përmirësimin e sigurisë së biznesit dhe përvojës së punonjësve, **Endpoint Central** ngre profesionalisht në nivel më të lartë detyrat e përditshme të administratorëve të TI-së me aftësitë e tij lidhur me:

- Kërcënimet dhe përditësimet
- Menaxhimi i Aseteve
- Menaxhimi dhe kontrolli i aplikacioneve
- Zgjidhja e problemeve në distancë
- Imazhi dhe vendosja e OS
- Raportet
- Akses me kusht

**ManageEngine**

- Menaxhimi i Certifikatës
- Menaxhimi i përmbajtjes
- Gjeo-skermë
- Menaxhimi i përditësimeve të OS
- Antivirus i gjeneratës tjetër
- Menaxhimi i BitLocker
- Kontrolli i motorëve në internet
- Kontrolli i pajisjes

> **ManageEngine Firewall Analyzer** u gjet si një zgjidhje raportimi browser-based dhe me dizenjime për të shfrytëzuar fuqinë e logeve. Nëpërmjet sistemit të ri Firewall Analyzer ASF IT mbledh, analizon dhe gjeneron raporte gjithëpërfshirëse mbi aktivitetin e firewall-it, VPN-së dhe serverëve. Ai ofron analiza ditore, javore, mujore dhe vjetore për të ndihmuar administrimin e rrjeteve e të:



- Sigurojnë rrjetet proaktivisht kundër kërcënimeve të mundshme.
- Parandalojnë abuzimet e rrjetit dhe të menaxhojnë me efikasitet bandëidht te rrjetit.
- Monitorojnë vizitat në faqet e internetit dhe të sigurojnë përdorim të përshtatshëm të rrjetit nga punonjësit.

# PERFORMANCA SOCIALE

Agro & Social Fund vlerëson, ndjek dhe synon përmiresimin e treguesve të Performancës Sociale duke respektuar përcaktimet ndërkombëtare mbi matjen dhe raportimin e tyre. Agro & Social Fund mat dhe raporton treguesit e performances sociale për të gjithë palët e interesuara:

➤ **Klientët**, të cilët mund të jenë të shqetësuar për etikën dhe impaktin social të blerjeve e investimeve të tyre, dhe se gjatë periudhës së vështirë që kaluam dhe po kalojmë kërkojnë të ndiejnë prezencën dhe afërsinë tonë në momentet e vështira.

➤ **Ortakët**, që kërkojnë të kenë në konsideratë impaktin social dhe rreziqet mjedisore për vendimet e tyre për investime, të cilët në periudha të tilla të vështira do të duan të sigurohen se institucioni **nuk po e humb fokusin e tij social.**

➤ **Komunitetet në të cilat operon**, që kërkojnë të dinë vlerën që ne kontribuojmë në shoqëri, veçanërisht në situata të tilla të jashtëzakonshme, ku fokusi social i institucioneve reflektohet më së shumti.

➤ **Punonjësit**, që duan siguri se kompania ku ata punojnë është një kompani që kujdeset për impaktin social dhe mjedisor që ka aktiviteti i saj, si dhe që tregon kujdes të shtuar për **mirëqenien shëndetsore fizike dhe mendore të stafit** kur punohet në kushte të veçanta të diktuar nga faktorë të jashtëm.

➤ **Partnerët**, të cilët kërkojnë të vihen në djeni për impaktin social të projekteve të implementuara në bashkëpunim me ASF dhe të sigurohen që edhe pse institucioni mund të jetë duke punuar në kushte jo shumë të favorshme të mos shkelë parimet sociale të deklaruar dhe kontraktuar.



**#1: No Poverty**

**#2: Zero Hunger**

**#3: Good Health and Well-Being**

**#4: Quality Education**

**#5: Gender Equality**

**#7: Affordable and Clean Energy**

**#8: Decent Work and Economic Growth**

**#9: Industry, Innovation and Infrastructure**

**#10: Reduced Inequalities**

**#11: Sustainable Cities and Communities**

**#14: Life Below Water**

**#15: Life on Land**

**#17: Partnerships for the Goals**



ASF vepron në përputhje me Sustainable Development Goals (SDG). Në terma të përgjithshëm, aktiviteti i ASF ka një ndikim, në shkallë të ndryshme, në trembëdhjetë SDG.

## Impakti Social

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, Agro & Social Fund ka:

Shërbyer **2,632 klientëve**

Ruajtur **5,876** & Krijuar **130 vende pune**

Përmirësuar jetën e **6,603 fëmijëve**

Financuar **44 sipërmarrje** të reja

Shërbyer **55.5% klientëve rurale** dhe **44% klientëve femra**

Shërbyer **706 klientëve për Edukim dhe Shëndetësi**

Shërbyer **1292 klientëve të rinj** (mosha 18-35 vjeç)

## Projekte dhe Partnerë



**Kiva** - Gjatë vitit 2024 në kiva janë financuar \$ 813,465.00, duke i ardhur kështu në ndihmë investimeve në Bujqësi, Edukim, Shëndetësi, Grave në zonat ruarle, Bizneseve të Reja, Të Rinjve Sipërmarrës dhe Komuniteteve Vulnerabël



**“Dorcas Aid International” Albania** - Projekti **“PËR NXITJEN E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E TROPOJËS dhe PUKËS NËPËRMJET KREDITIMIT”** u nënshkrua rishtazi me qëllim vënien në dispozicion të një fondi të ri, i cili do të përdoret me qëllim vazhdimin e suportimit të familjeve në nevojë; dhe nga ana tjetër të nxitjes së mëtejshme të atyre familjeve që në fazën e parë u ndihmuan të nisin një sipërmarrje. Kjo marrëveshje paraqitet me të njëjtat terma si ato të herës së kaluar.



**SwissContact** – Gjatë vitit 2024 vijoi bashkëpunimi me SwissContact, në sajë të të cilit u realizuan disa trajnime gjatë vitit për oficerët e kredisë si dhe për menaxherët e degëve. Nëpërmjet këtyre trajnimeve, stafi i ASF thelloi dhe zgjeroi njohuritë në aspekte të ndryshme të proçeseve të punës, ku në thelb qëndron ofrimi i një shërbimi sa më etik dhe cilësor ndaj klientëve tanë. Gjithashtu edhe përgjatë këtij viti, oficerët e kredisë asituan në takime me të rinjtë sipërmarrës ku dhanë ekspertizën e tyre për të ndihmuar ata të kuptojnë më mirë të gjithë procesin e kredisë si dhe parandalimin e mbingarkesës me borxhe.

# KLIENTËT TANË

## Albana Çekiçi



Albana, me profesion kuzhinierë jeton me bashkëshortin dhe djalë të saj. Ajo merret gjithashtu me bujqësi duke qënë një zonjë tejet ambicioze dhe e përkushtuar ndaj mirëqënies së familjes së saj. Pavarësisht punës dhe lodhjes, bujqësia gjithashtu ka nevojë për investime, gjë që Albana nuk e përmbushte dot në kohën kur i nevojitet të shpenzonte për këtë aktivitet. Me financimin që mori në ASF, Albana arriti të paguante shpenzimet e nevojshme gjatë sezonit të mbjelljes, gjë e cila dha frytet e veta në fund të sezonit me produktet që ajo arriti të shiste. Albana është tejet mirënjohëse për mundësinë e ofruar, pasi falë kësaj ajo arriti të shtonte të ardhurat e familjes.

## Rudina Dervishllari



Rudina, është e martuar dhe nënë e dy fëmijëve. Ajo dhe bashkëshorti merren me bujqësi, aktivitet nga i cili gjenerojnë të ardhura për të mbajtur familjen e tyre. Rudina është një kliente e hrshme e ASF dhe ka gjetur mbështetje në disa periudha delikate të jetës së saj, sic ishte rasti kur duhet të paguante për shpenzime shëndetsore për të shoqin apo në një tjetër rast për të zgjeruar aktivitetin që ajo dhe i shoqi ushtrojnë, gjë e cila familjen e tyre të kenë më shumë të ardhura. Rudina është falenderuese për suportin ndër vite që ka marrë nga ASF.



**BILANCI**  
(Shumat në mijë Lek)

|                                               | 2024             | 2023             |
|-----------------------------------------------|------------------|------------------|
| <b>Aktivët</b>                                |                  |                  |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet me to         | 346,227          | 75,356           |
| Hua dhe paradhënie për klientët               | 1,217,601        | 1,097,365        |
| Aktivët afatgjata materiale                   | 11,663           | 11,509           |
| Të drejtat e përdorimit të aktiveve           | 49,044           | 69,514           |
| Aktive të tjera                               | 13,540           | 10,316           |
| <b>Totali i aktiveve</b>                      | <b>1,638,075</b> | <b>1,264,060</b> |
| <b>Detyrimet dhe Kapitali i vet</b>           |                  |                  |
| <b>Detyrimet</b>                              |                  |                  |
| Huate                                         | 1,131,153        | 765,090          |
| Detyrimet mbi Qeratë                          | 49,065           | 69,574           |
| Detyrime të tjera                             | 27,435           | 29,855           |
|                                               | <b>1,207,653</b> | <b>864,519</b>   |
| <b>Kapitali i vet</b>                         |                  |                  |
| Kapitali aksionar                             | 289,375          | 289,375          |
| Humbje të mbartura                            | 110,166          | 60,426           |
| Fitimi i vitit                                | 30,881           | 49,740           |
|                                               | <b>430,422</b>   | <b>399,541</b>   |
| <b>Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet</b> | <b>1,638,075</b> | <b>1,264,060</b> |

**PASQYRA E TË ARDHURAVE**  
(Shumat në mijë Lek)



|                                                                    | 2024            | 2023            |
|--------------------------------------------------------------------|-----------------|-----------------|
| Të ardhura nga interesit                                           | 330,034         | 279,157         |
| Shpenzime për interesa                                             | -64,275         | -47,831         |
| Të ardhura neto nga interes                                        | <b>265,759</b>  | <b>231,326</b>  |
| Të ardhura/(Shpenzime) të tjera                                    | 2,715           | 829             |
| <b>Shpenzime operative</b>                                         |                 |                 |
| Amortizim i aktiveve                                               | -20,376         | -16,480         |
| Shpenzime personeli                                                | -139,305        | -116,892        |
| Humbje nga zhvlerësimi i huave                                     | -23,042         | -11,278         |
| Shpenzime të tjera                                                 | -45,288         | -29,129         |
| Fitim/(humbje) neto nga kurset e këmbimit                          | 237             | 1,882           |
| <b>Totali i shpenzimeve operative</b>                              | <b>-227,774</b> | <b>-171,897</b> |
| <b>Fitim/(humbja) përpara tatimit</b>                              | <b>40,700</b>   | <b>60,258</b>   |
| Tatim fitimi                                                       | -9,819          | -10,518         |
| <b>Fitim/(humbja) për vitin</b>                                    | <b>30,881</b>   | <b>49,740</b>   |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit                 |                 |                 |
| <b>Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin</b> | <b>30,881</b>   | <b>49,740</b>   |

**PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË**  
(Shumat në mijë Lek)

|                                                      | 2024            | 2023            |
|------------------------------------------------------|-----------------|-----------------|
| <b>Flukset monetare nga aktivitetet operacionale</b> |                 |                 |
| Fitimi i vitit përpara tatimit                       | <b>40,700</b>   | <b>60,258</b>   |
| <i>Korrigjime për:</i>                               |                 |                 |
| Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale            | 2,789           | 2,724           |
| Amortizimi i të drejtave të përdorimit të aktiveve   | 17,682          | 13,757          |
| Nxjerrja jashtë përdorimit i aseteve fikse           |                 |                 |
| Humbje nga zhvlerësimi i huave                       | 23,042          | 11,278          |
| Të ardhura nga interesit                             | -330,034        | -279,157        |
| Shpenzime për interesa                               | 64,275          | 47,831          |
| <i>Ndryshime në:</i>                                 |                 |                 |
| Hua dhe paradhënie për klientët                      | -143,254        | -144,839        |
| Aktive të tjera                                      | -6,812          | 1,095           |
| Detyrime të tjera                                    | -2,420          | 9,204           |
|                                                      | <b>-334,032</b> | <b>-277,849</b> |
| Interesi i arkëtuar                                  | 330,010         | 280,084         |
| Interesi i paguar                                    | -58,403         | -43,990         |
| Tatimi mbi të ardhurat i paguar                      | -6,270          | -6,519          |

|                                                                  | 2024           | 2023          |
|------------------------------------------------------------------|----------------|---------------|
| <b>Flukset monetare të përdorura në aktivitetet operacionale</b> | <b>-68,695</b> | <b>48,274</b> |
| <b>Flukse monetare nga aktivitetet investuese</b>                |                |               |
| Shitje e aktiveve afatgjata materiale                            |                |               |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale                            | -2,943         | -2,661        |
| <b>Flukset monetare përdorur në aktivitetet investuese</b>       | <b>-2,943</b>  | <b>-2,661</b> |
| <b>Flukset monetare nga aktivitetet financiare</b>               |                |               |
| Fonde të marrë si hua                                            | 2,407,387      | 4,419,632     |
| Fonde të paguara si hua                                          | -2,045,887     | -4,377,685    |
| Ripagesa për Detyrimet mbi Qeratë                                | -18,991        | -16,432       |
| <b>Flukset monetare nga aktivitetet financiare</b>               | <b>342,509</b> | <b>25,515</b> |
| (Rënia)/rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to   | 270,871        | -25,419       |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit         | 75,356         | 100,775       |
| <b>Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit</b>    | <b>346,227</b> | <b>75,356</b> |

# BASHKËPUNËTORËT TANË



# RRJETET TONA SOCIALE



[www.asf.al](http://www.asf.al)



[agrosocialfund.shpk](https://www.instagram.com/agrosocialfund.shpk)



Agro & Social Fund



Agro Social Fund





